



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.228/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat nga kandidatëve nga subjekti politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan Emine Hoxhaj, Shefqet Demhasaj, Flamur Avdimetaj, Rexhë Sadikaj, Nasret Delijaj, Smajl Neziraj, Valmire Hajrizaj, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 17.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

HEDHEN të palejuara ankesat ZL.Anr.228/2025, ZL.Anr.229/2025, ZL.Anr.230/2025, ZL.Anr.231/2025, ZL.Anr.232/2025, ZL.Anr.233/2025, ZL.Anr.234/2025 të datës 16.10.2025, të parashtruar nga kandidatët e Subjektit Politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan Emine Hoxhaj, Shefqet Demhasaj, Flamur Avdimetaj, Rexhë Sadikaj, Nasret Delijaj, Smajl Neziraj, Valmire Hajrizaj, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 16.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.228/2025, ZL.Anr.229/2025, ZL.Anr.230/2025, ZL.Anr.231/2025, ZL.Anr.232/2025, ZL.Anr.233/2025, ZL.Anr.234/2025, të parashtruar nga kandidatët e Subjektit Politik Iniciativa Demokracia, me seli në Deçan Emine Hoxhaj, Shefqet Demhasaj, Flamur Avdimetaj, Rexhë Sadikaj, Nasret Delijaj, Smajl Neziraj, Valmire Hajrizaj, në të cilat kërkojnë që të urdhërohet qendra për rinumërimin e votave që në komunën e Deçanit të bëhet rinumërimi i votave brenda subjektit politik Iniciativa Demokracia. Parashtruesit e ankesave konsiderojnë se gjatë numërimit të votave, ka gabime në rezultatet përfundimtare, ku me bindje të plotë theksojnë se kanë më shumë vota se sa janë publikuar nga KQZ-ja. Të njëjtit kërkojnë nga PZAP-ja që ankesat të aprovohen.

Në përgjigje në ankesë KQZ thekson se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet/ përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr. 16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e

Veprimet në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar Qendrat e Votimit ose vendvotimet përkatëse ku pretendon se janë bërë shkelje ose parregullsi, arsyet e mospërputhjes me ndonjë dokument, siç janë, raportet e vëzhguesve të akredituar nga KQZ, Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e KVV etj.

Palët kanë bërë ankesë ndaj rezultateve përfundimtare mirëpo këto rezultate ende nuk janë publikuar, andaj në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë,

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.228/2025, ZL.Anr.229/2025, ZL.Anr.230/2025, ZL.Anr.231/2025 ZL.Anr.232/2025, ZL.Anr.233/2025, ZL.Anr.234/2025 të datës 16.10.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.228/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të e palejuara.

Paneli vlerëson se pretendimet e palëve ankuese edhe pse i referohen parregullsi në numërimin e votimit, për shkak se përmes ankesave atakohet rezultati i votimit, e që kanë të bëjë me numërimin e votave në Qendrën Komunale në Komunën e Deçanit, me datë 15.10.2025, kur ka përfunduar numërimi i votave, i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, pra nuk është rezultat përfundimtar i zgjedhjeve i shpallur me vendim nga KQZ, prandaj në këto rrethana ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se në pajtim me nenin 106 par. 3 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës pas shpalljes së rezultatit përfundimtar me vendim të KQZ i njëjti rezultat është i ankimuar nga personi fizik ose juridik të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Neni 106 par. 3 i Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet E Përgjithshme në Republikën e Kosovës parasheh se personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrojë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraparakisht”* dhe Neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, si dhe neni 13 paragrafi 6 i në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.228/2025 më datën 17.10.2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.